

VENDIM
Nr. 92/2017

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS
DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOLEGJIT
TË POSAÇËM TË APELIMIT**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të neneve 18, pika 1, dhe 29 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- III. Struktura organizative e personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit është sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 29.9.2017

Lidhja nr. 1

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJIT
TË POSAÇËM TË APELIMIT**

Funksioni organik	Klasifikimi i pagës	Numri (2)
I. KRYETAR	G3*	1
Sekretar	Sekretar në kabinetin e Kryetarit të Kuvendit**	1
II. KOLEGJI I GJYQTARËVE		(6)
Gjyqtarë	G3*	6
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(10)
Këshilltarë juristë	80% e G3*	7
Këshilltarë ekonomistë	80% e G3*	3
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-a	1
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		(10)
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	IV-a	3
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-b	1
Përkthyes	II-b	3
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritje me popullin	IV-b	1

**VI. DREJTORIA EKONOMIKE
DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

(8)

Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT	III-b	1
Specialist protokoll/arkiv	IV-b	1
Magaznier	VII	1
Punonjës pastrimi	III	1
Shofer	V	1
Gjithsej		37

Shënim:

**Paga e gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit përlllogaritet me këtë formulë: $G3 + 10\% G3 +$ shtesën për vjetërsi (e barasvlershme me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.*

***Kategoria e pagës për sekretarin e Kryetarit është sipas VKM-së nr. 187/2017.*

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOLEGJIT TE POSACEM TE APELIMIT

